REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
297/19
Data/Datum: 10.06.19
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Një ankesë kundër: **MINISTRIA E INFRASTRUKTURES DHE TRANSPORTIT**

Për Aktivitetin e Prokurimit: **205-19-2318-5-1-1, MI 19 033 511**

Sa i përket tenderit për: **"Zgjerimi i rrugës nacionale N 9.1, segmenti Dollc-Gjakovë , L=31.00 " – LOT 3**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

RSM COMPANY SH.P.K.
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

ÇAGLLAVICE, P.N. PRISHTINE
(Adresa)

PRISHTINE	**10000**
(Vendi)	*(Kodi postar)*
045 977 750	***N.A.***
(Numri Telefonit)	*(Numri i Faks-it)*

AGIM KOLA
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)
rsm.prishtina@gmail.com
(Adresa elektronike)

RSM Company sh.p.k. PRISHTINE

10.06.2019
(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit)(Numri i faks-it)

_____

(Adresa elektronike)

_____

(Data e parashtrimit të ankesës)(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" apo "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

*Njoftimi per kontrate eshte publikuar me dt.**22.04.2019***
*Afati i fundit per dorezim ka qene me dt: **15.05.2019, ora 14:00***
Kriteri per dhenien e kontrates: ***Tenderi i pergjegjshem me cmimin me te ulet***

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po	☐				**Jo**	✓

Nuk kemi marre pjese ne procesin e Hapjes se tendereve.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shtesë nga AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:

Po	X				**Jo**		

Per eliminimin tone nga ky aktivitet i prokurimit jemi njoftuar permes Njoftimit per Vendimin e AK-se, te publikuar me dt. **03.06.2019** ne e-prokurim.

Kemi bere kerkese per rishqyrtim prane AK-se me dt. **05.06.2019.**

Vendimi mbi refuzimin e kerkeses per rishqyrtim na eshte derguar permes e-prokurimit me dt: **05.06.2019**.

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Autoriteti kontraktues ka bërë shkeljen e dispozitave të Ligjit mbi Prokurimin Publik në Republiken e Kosovës, Nr. 04/L-042 I ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, dhe Dosjes se Tenderit, Pikat 9.1 & 9.2, nenpika 6 dhe 7:

Neni 1 - Qellimi

Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Neni 60 - Kriteret per Dhenien e Kontrates

Neni 69 - Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Neni 1 - Qellimi thote: "Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla."

Kurse Autoriteti Kontraktues ka bere shkelje te ketij neni, pasi qe me vendimin e saj, ka per qellim demtimin e fondeve publike ne vlere prej **144,844.10 Euro, pasi qe kompania e shpallur fituese ne Lot III "Lika Trade" ka ofertuar me shtrenjte se RSM Company e cila ka ofruar tenderin e pergjegjshem me cmimin me te ulet ne Lot III.**

Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Autoriteti Kontraktues ka bere shkelje te ketij neni, duke vleresuar gabimisht dhe ne mos perputhje me Ligjin e Prokurimit, duke eliminuar kompanine RSM Company shpk, edhe pse kemi dorezuar oferte te pergjegjshme dhe ne perputhje me te gjitha kerkesat e Dosjes se Tenderit.

Neni 60 - Kriteret per Dhenien e Kontrates

Autoriteti Kontraktues ben shkelje te paragrafit 1.1 te ketij neni, duke mos shpallur fitues kompanine e cila ka dorezuar oferte te pergjegjshme,dhe duke demtuar kompanine RSM Company shpk, e cila edhe pse ka dorezuar oferte te pergjegjshme, ne pajtueshmeri te plote me kerkesat e dosjes se tenderit, eshte eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit.

Neni 69 - Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

Ne Dosje te tenderit pika 6 eshte kerkuar: Lista e kontratave te realizuara perfunduara ne lëmine e kërkuar për periudhën e shkuar tre vjeçare jo më pak se 10,000,000.00 euro per pjesën I , 8,000,000.00 euro per pjesën II dhe **6,000,000.00 për pjesën III**. Operatori ekonomik duhet të ketë projekte të realizuara në lëmin e asfaltimit, ndërtimit, rehabilitimit, rikonstruktimit të rrugëve, dhe si deshmi te paraqiten: Deshmia 6. Procesverbalet e pranimit përfundimtar të punëve duke treguar vlerën, datën, natyrën dhe vendndodhjen e projekteve ne lëmine e kërkuar per periudhën e shkuar tre vjeçare.

Kurse ne kemi paraqitur listen e kontratave te perfunduara ne 3 vitet e fundit ne lemine e kerkuar ne vlere prej **7,347,432.75 Euro,** dhe si deshmi kemi paraqitur kontratat dhe pranimet teknike/referencat per keto projekte:

1. **Rikonstruimi I rruges Kukes - Shishtavec Lot 3, Regjioni I Kukesit, me vlere: 3,043,477 Euro**
2. **Rikonstruimi I Bulevardit Fan Noli dhe Ndricimi I Unazes Korce, me vlere: 1,330,405.80 Euro**
3. **Rikonstuksion I rrugeve te lagjeve Maknor-Kolje-Ledhe, me vlere: 458,457.64 Euro**
4. **Asfaltim I rruges Shefqet Kuka, me vlere: 464,122.51 Euro**
5. **Zgjerimi I rruges ne Qytetin e Pejes, me vlere: 2,050,969.81**

Pra vlera e kontratave te paraqitura se bashku me deshmite e kerkuara arrin vleren prej **7,347,432.75 Euro,** pra kemi tejkaluar kerkesen e AK-se per lotin III qe ka qene **6,000,000 Euro.** Kurse AK-ja na ka eliminuar me arsyetimin se kemi paraqitur kontrata ne vlere prej **5,992,504.67 Euro,** qe nuk eshte fare e vertete pasi qe te gjitha keto deshmi jane te paraqitura/ngarkuara ne eprokurim dhe verifikohen fare lehte. – **PROVE: Lista e kontratave te perfunduara dhe procesverbalet e pranimeve teknike/referencat, te cilat gjenden edhe ne dokumentacioni e ngarkuar ne eprokurim.**

Ne pergjigjen e AK-se ne lidhje me vleren e kontratave, e kane zbritur edhe me shume vleren valide te kontratave sipas atyre. ku ata kane arsyetuar se kontrata me titull : Rikonstruimi I rruges Kukes - Shishtavec Lot 3, Regjioni I Kukesit, me vlere: 3,043,477

Euro, eshte kryer nga kompania RSM Company shpk vetem vlera prej 60 % e asaj kontrate. Por ne po ju ofrojme si deshmi Marreveshjen ne mes te RSM Company shpk & Eskavatori shpk, ne te cilen theksohet se Eskavatori terhiqet nga ekzekutimi I punimeve dhe se RSM Company shpk eshte pergjegjes 100% per ekzekutimin e punimeve, dhe poashtu situacionet e dorezuara tek Investitori, ku shihet qarte qe te gjitha situacionet jane te nenshkruara dhe dorezuara vetem nga ana e RSM Company shpk.

Poashtu AK-ja nuk ka pranuar si kontrate valide kontraten me titull: Rikonstruimi I Bulevardit Fan Noli dhe Ndricimi I Unazes Korce, me vlere: 1,330,405.80 Euro, per te cilen pretendojne qe nuk eshte kontrate ne lemine e kerkuar (Asfaltim, Ndertim, rehabilitim, rikonstruktim te rrugeve), qe nuk eshte fare e vertete pasi qe shumica derrmuese e vleres se kontrates eshte tek asfalti, dhe per me teper kjo kontrate perfshin te gjitha pozicionet e ndertimit te rrugeve, dhe jo ashtu sic pretendon AK-ja. Si prove ju ofrojme te gjitha situacionet e punimeve per kete projekt qe te vertetohet qe kjo kontrate eshte ne lemine e kerkuar ne DT.

Ne Dosje te tenderit **Pika 7 - lista e makinerive**, pika 10 eshte kerkuar **"Finisher per shtrirjen e asfaltit"**, ne kemi paraqitur marreveshjen per makineri te noterizuar mes RSM Company shpk dhe Rruga Ing shpk, dhe si deshmi per finisherin Caterpillar AP755, kemi paraqitur Faturen e shitblerjes se makinerive, ku Finisheri eshte i listuar i pari ne ate fature me pershkrimin: **"Caterpillar Finisher AP755-8.1m" , per me teper ne ate fature gjendet edhe Sperkatesja per bitumen dhe emulsion qe eshte paraqitur ne listen e makinerive**, kurse AK-ja na ka eliminuar me arsyen se kinse nuk kemi paraqitur deshmi per finisherin. – **PROVE: Marreveshja per makineri me Rruga Ing dhe Fatura e shitblerjes se makinerive (Shitesi Al Trade – Bleresi Rruga Ing.) te cilat gjinden edhe ne dokumentacionin e ngarkuar ne eprokurim.**

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:

Parashtruesit e kësaj kerkese kane bërë shpenzime të mëdha lidhur me përgatitjen e Dosjes së Tenderit, vlera e të cilave do të përcaktohet në të ardhmen, për çka pason vlerësimi me shkrim.

9. Propozim

Ofroni, nëse është e mundur propozimin tuaj për hapat e mëtutjeshëm në lidhje me këtë aktivitet të prokurimi:

Parashtruesit e kësaj ankese, i propozojne OSHP-së :

- **që të korrigjojë shkeljet e vërtetuara si më lartë ,të parandalojë dëmtimin e mëtejmë të parashtruesit të ankesës, dhe te ktheje lenden ne rivleresim, pasi qe ne si OE jemi te pergjegjshem dhe I kemi plotesuar te gjitha kriteret e dosjes se tenderit. Ne si OE, mbesim me shprese qe OSHP-ja, ankesen tone ta vleresoje drejte dhe ti parandaloje padrejtesite dhe humbjet ne aspektin financiar qe na shkaktohen dhe te na shpalle fitues.**

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
- *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve,*
- *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*
- *Kerkesen per Rishqyrtim prane AK-se*
- *Vendimin per Refuzim te kerkeses per rishqyrtim*
- *Lista e kontratave dhe kontratat e dorezuara me Pranime teknike/referenca*
- *Marreveshjen mes RSM Company & Eskavatori shpk, per terheqjen e Eskavatorit nga ekzekutimi i projektit "Rikonstruimi I rruges Kukes-Shishtavec Lot 3 Regjioni I Kukesit"*
- *Situacionet e projektit: "Rikonstruimi I Bulevardit Fan Noli dhe Ndricimi I Unazes Korce" qe deshmon qe ky projekt ka qene ndertim/asfaltim I rrugeve.*
- *Situacionet e projektit: Rikonstruimi I rruges Kukes-Shishtavec Lot 3 Regjioni I Kukesit" qe deshmon qe kompania RSM Company I ka kryer dhe faturuar te gjitha punimet.*
- *Marreveshja per makineri mes RSM Company – Rruga Ing, si dhe fatura e dorezuar si deshmi per Finisherin e Asfaltit*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*